

## **Kthimi i migrantëve, ndërmarrësia dhe zhvillimi në Kosovën rurale**

Lumnije Kadriu

Instituti Albanologjik i Prishtinës,  
Prishtinë, Kosovë  
lume70@hotmail.com

### **Abstrakti**

Kthimi i migrantëve është bërë një prirje tejet e theksuar në trajektoret migratore të lëvizshmërisë së njerëzve dhe për këtë arsye edhe po hulumtohet gjithnjë e më shumë, duke zbuluar kështu një mori nuancash dhe përvojash të lidhura me të. Shpesh, motivi për emigrim bazohet në dëshirën dhe synimin për të arritur sukses, i cili pritet të japë fryte pas kthimit. Megjithatë, të kthyerit përballen me sfida të ndryshme që ishin dhe vazhdojnë të jenë të shqyrtuara e të shpjeguara nga teoritë e kthimit të migrantëve. Edhe pse Kosova njihet kryesisht si vend emigrimi për shkak të historisë së saj të trazuar politike dhe sfidave të vazhdueshme ekonomike, ekzistojnë raste të dokumentuara të kthimit të vullnetshëm të migrantëve. Në këtë punim do të paraqes përvojat e disa emigrantëve të kthyer që janë me kualifikime të ulëta profesionale, por të cilët pas kthimit themeluan biznese në fshatrat e tyre të origjinës, duke sjellë një shkallë të caktuar zhvillimi dhe ngritje të statusit social si në nivel personal, ashtu edhe komunitar. Kthimi i punëtorëve me kualifikime të ulëta në zonat rurale mund të jetë ndër kthimet më sfiduese, duke marrë parasysh mundësitë e kufizuara që këto zona zakonisht ofrojnë. Megjithatë, dinamika të reja, veçanërisht në lidhje me potencialin turistik, po shfaqen në zonat rurale. Rastet në këtë punim janë mjaft unike dhe shërbejnë si ilustrim i veprimeve të ndryshme individuale të migrantëve që janë përdorur si strategji për kthim.

**Fjalë kyçe:** *Kthimi i migrantëve, rural, ndërmarrësia, mobiliteti social, zhvillim.*

### **Hyrje**

Karakteristika më e rëndësishme e migrimit, pavarësisht drejtimin e tij – qoftë largimit apo kthimit – është dëshira për të siguruar dhe arritur një jetë më të mirë për migrantin si individ dhe për familjen e tij. Studimet për kthimin e migrantëve janë bërë pjesë gjithnjë e më e rëndësishme e studimeve mbi migrimin, pasi vëllimi në rritje i tyre mundëson analizën nga perspektiva dhe disiplina të ndryshme. Janë identifikuar dhe analizuar disa lloje, nuanca dhe ndikime të kthimit të migrantëve përmes qasjeve të

ndryshme, si: ekonomia neoklasike, ekonomia e re e migrimit të punës (NELM), qasja strukturore, qasja transnacionale dhe teoria e rrjeteve shoqërore. Qasjet transnacionale dhe të rrjeteve shoqërore kanë rezultuar veçanërisht të frytshme, pasi e shqyrtojnë kthimin e migrantëve nga këndvështrime të ndryshme, duke përfshirë lëvizshmërinë e vazhdueshme të njerëzve, lidhjet e tyre me vendet pritëse dhe të origjinës, transferimin e mallrave dhe të informacioneve, si dhe ndërveprimin e tyre brenda këtyre konteksteve. Kthimi i suksesshëm shpesh rezulton me ngritje të statusit social për migrantët e kthyer dhe familjet e tyre, si dhe kontribuon në zhvillimin lokal të vendit kthyes.

Edhe pse Kosova është ndër vendet më të varfra në Evropë dhe dëshira e popullsisë së saj për të emigruar mbetet e fortë, fenomeni i kthimit të migrantëve, në veçanti kthimi i vullnetshëm, po bëhet gjithnjë e më evident. Këtu e përdor termin ‘kthim i vullnetshëm’ për ta dalluar nga i ashtuquajti ‘kthim vullnetar’ që zakonisht ka të bëjë me të kthyerit që sponsorizohen dhe rezultojnë nga mungesa e ndonjë alternative më të mirë për ta. (Për më shumë, shih: Bivand-Erdal dhe Oeppen, 2022, fq. 70-83; Kadriu 2024, fq. 95-117). Në këtë tekst, termi ‘vullnetar’ do të konotojë atë të ‘vullnetshëm’ edhe nëse nuk theksohet në mënyrë eksplicite secilën herë. Vlen të përmendet se valët e ndryshme të emigrimit të shqiptarëve të Kosovës që nga vitet 1960 (Mustafa et al. 2007, fq. 27; Kadriu 2022, fq. 97-98), të cilat ishin rezultat i marrëveshjeve ndërmjet ish-shtetit jugosllav dhe Gjermanisë e Zvicrës lidhur me politikën e migrimit të “punëtorëve sezonalë”, çuan në kthime të vazhdueshme.

Kosova ishte një vend bujqësor, prandaj shumica e migrantëve ishin nga zonat rurale.<sup>1</sup> Si rrjedhojë, edhe kthimet ndodhin shpesh në të njëjtat vende nga ku ata janë larguar. Megjithatë, po evidentohet gjithnjë e më shumë se të kthyerit mund të zgjedhin të vendosen në zonat e afërta urbane apo në kryeqytet, të tërhequr nga mundësitë më të mëdha në to si edhe nga faktorë të tjerë.<sup>2</sup> Sidoqoftë, të dhënat e besueshme për numrin e të kthyerve vullnetarë mungojnë, pasi ata nuk regjistrohen në të dhënat zyrtare të programeve të kthimit dhe koha e kthimit të tyre bazohet në vendime personale apo familjare.

Një tjetër karakteristikë e rëndësishme është se, pavarësisht rritjes së larmisë së profileve arsimore të migrantëve që nga vitet 1990, migrantët nga zonat rurale në Kosovë ishin shpesh punëtorë me kualifikime të ulëta dhe me arsimim të kufizuar, ngjashëm me migrantët nga vende të tjera (Farrell et al. 2012, fq. 31–44; Hagan dhe Wassink, 2019; Mustafa et al. 2007, fq. 27; Galloopeni 2016, fq. 296). Si rezultat, pasi mbërrinin në vendin pritës, ata rëndom ushtronin profesione me kualifikim të ulët dhe merrnin pak vëmendje. Megjithatë, nëse zgjedhin të kthehen vullnetshëm pas një kohe të caktuar, kanë mundësi të mira për sukses dhe ngritje të statusit social përmes grumbullimit të kapitalit financiar, shoqëror, njerëzor dhe kulturor. Pra, edhe pa arsimim profesional në vendin pritës, atyre u mundësohet një kthim i suksesshëm falë përvojave, rrjetëzimit, si dhe njohurive e shkathtësive që kanë fituar për biznese të caktuara ose nisma ndërmarrësie. Koncepti i “shkathtësisë” dhe dallimi mes punëtorëve/migrantëve “të lartëkualifikuar” dhe “të ulët kualifikuar” ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve dhe është definuar ndryshe nga ekonomistët, sociologët dhe politikëbërësit (Kubiciel-Lodzińska dhe Maj 2021; Weinar dhe Klekowski von Koppenfels 2020; Pastore dhe Tomei 2018). Në këtë punim, si punëtorët me kualifikim të lartëdefinojnë ata që kanë një diplomë universitare (Iredale, 2016), ndërsa punëtorët me arsim të mesëm ose më të

ulët, apo ata që janë ende në proces studimi, përfshihen në kategorinë e punëtorëve me kualifikim të ulët. (Kubiciel-Lodzińska dhe Maj 2021, fq. 1552). Ndikimi i migrimit dhe zhvillimit në zonat rurale, i nxitur nga remitancat, është studiuar në disa punime antropologjike (Reineck 1998, Kadriu 2016, Leutloff-Grandits 2023). Megjithatë, në Kosovë nuk ka pasur hulumtime antropologjike të fokusuara në mënyrë specifike për kthimin e migrantëve në zonat rurale, si dhe zhvillimin apo ndryshimin e statusit social të tyre që rrjedh nga ndërmarrësia. Në raste të këtilla, ngritja e statusit social të migrantëve është shpesh e pritshme. Pitirim Sorokin e prezantoi dhe e përkufizoi mobilitetin social (d.m.th. ndryshimin e statusit social) si “çdo kalim të një individi [...] nga një pozitë shoqërore në një tjetër” (1959, fq. 133). Ai identifikoi dy lloje të mobilitetit social: mobilitetin horizontal, që nënkupton kalimin e një individi ose subjekti shoqëror nga një grup shoqëror në një tjetër në të njëjtin nivel, dhe mobilitetin vertikal, që përfshin lëvizjen nga një shtresë shoqërore në një tjetër – qoftë më të lartë (upward) qoftë më të ulët (downward).

Ky punim paraqet përvojat e disa migrantëve të kthyer me kualifikim të ulët, të cilët kanë themeluar me sukses biznese apo ndërmarrje biznesi nëpër zona rurale. Aspektet etnografike dhe përshkruese të këtyre rasteve bazohen në bisedat me të kthyerit, të zhvilluara përmes intervistave të hapura dhe gjysmë të strukturuar në fshatrat e tyre (nga viti 2018 deri në 2024). Disa raste të të kthyerve, që kishin investuar në vendlindjet e tyre, i kam hasur spontanisht gjatë punës sime në terren për projekte të ndryshme kërkimore.<sup>3</sup> Disa prej tyre i kam identifikuar gjatë diskutimeve me miq dhe kolegë, ndërsa të tjerët i zbulova përmes intervistave të shkurtra të tyre në emisione televizive, të cilat më motivuan t’i vizitoj personalisht. Për këtë punim kam përzgjedhur tri raste të migrantëve të kthyer kosovarë nga vende të ndryshme perëndimore (Zvicër, Gjermani dhe Sllovaki), në fshatra të ndryshme të Kosovës. Dy nga këto raste përfshijnë migrantë të gjeneratës së parë të cilët, në kohën e migrimit, ishin ende duke u shkolluar: njëri nxënës i shkollës së mesme dhe tjetri student universiteti. Meqë ishin me origjinë rurale ata kishin përvojë e njohuri në punët bujqësore. Rasti i tretë përfshin gjithashtu një migrant me prejardhje rurale, por në këtë rast, anëtarë të pesë gjeneratave me radhë, të familjes së tij, kishin shkuar për punë jashtë vendit. Ata kanë punuar si furrtarë në vende të ndryshme, duke filluar në Serbi, më pas në Vojvodinë, Rumani dhe përfundimisht janë vendosur në Sllovaki. Gjatë kthimeve sezonale në fshat, ata punonin gjithashtu arat e tyre.

Në të tria rastet, njohuritë dhe shkathtësitë (pra, kapitali njerëzor) që kishin fituar si anëtarë të familjeve me prejardhje bujqësore, u ndihmuan të gjenin punë në vendin pritës. Ndërsa, nga ana tjetër, përvoja e fituar jashtë vendit ua lehtësoi atyre ndërmarrësinë dhe ndryshimin e statusit social pas kthimit. Në rastin e parë, i kthyeri u bë kultivues bimësh; në të dytin, ndërmarrës i produkteve bio (duke prodhuar vezë, mjaltë, produkte qumështi, fruta dhe perime); dhe në të tretin, prodhues vere. Emrat e përdorur në tekst janë ndërruar për të ruajtur anonimitetin e bashkëbiseduesve. Pëlqimi për përdorimin e rrëfimeve të tyre u mor verbalisht para regjistrimit të bisedës. Për t’i kuptuar këto përvoja në kontekstin e kthimit të migrantëve, pjesa e parë e punimit ofron një hyrje të shkurtër mbi kornizat teorike të këtij llojifenomeni, si dhe konceptin e zhvillimit në këtë kontekst. Më pas do të prezantohen tri rastet e përmendura, duke ilustruar kthime të suksesshme me ndikim zhvillimor.

## Studimet për kthimin e migrantëve

Edhe pse kthimi i migrantëve në vendlindje ka qenë pothuajse gjithmonë i pranishëm si fenomen, në literaturën shkencore përmendet shkurt tek gjatë viteve 1950 (King 2000, 27). Zhvillimi i tij si fushë studimore filloi në vitet 1960, duke marrë hov të konsiderueshëm që nga vitet 1970 (King 2000, 27; Cassarino 2004). Sot, konsiderohet një nëndegë ose disiplinë brenda studimeve të migrimit (King dhe Kuschminder 2022, 8; Čapo 2024, 12). Si rezultat, disa autorë ndërkohë kanë propozuar tipologji të ndryshme të kthimit të migrantëve. Për shembull, në vitin 1974, Bovenkerk e klasifikoi tipologjinë e kthimit të migrantëve bazuar në katër faktorë: nivelin e zhvillimit të vendit pritës dhe atij të origjinës (vendet e varfra kundrejt vendeve të pasura dhe të zhvilluara), kohën e kaluar në vendin pritës, distancën mes vendeve dhe motivimet e rrethanat e kthimit. Tipologjia e Francesco P. Cerase e vitit 1974 përfshin katër kategori: kthimin për shkak të dështimit, kthimin konservator, kthimin inovativ dhe kthimin e (pas)pensionimit. Në vitin 2018, Graziano Battistella propozoi gjithashtu katër lloje: kthimin pas arritjes së qëllimit, kthimin pas përfundimit të një cikli, kthimin për shkak të pengesave dhe kthimin e detyruar ose (për shkak) të krizës (King 2000; King & Kuschminder 2022, 4–5). Krahas këtyre tipologjive, ekzistojnë edhe disa korniza teorike për të kuptuar më thellësisht kthimin e migrantëve.

Në vitin 2004, Jean-Pierre Cassarino zhvilloi pesë korniza teorike, të cilat shpjegohen shkurtimisht më poshtë. Qasja e *ekonomisë neoklasike* fokusohet në kthimin e migrantëve si rezultat i dallimeve reale në të ardhura midis vendeve dërguese dhe atyre pritëse. Migrimi konsiderohet si njëkahësh dhe kthimi shihet si dështim. Qasja e *ekonomisë së re të migrimit të punës* (NELM) e sheh kthimin si rezultat logjik të një “strategjie të kalkuluar”, të përcaktuar në nivel familjar ose shtëpiak, që vjen pas përmbushjes së suksesshme të një qëllimi. Sipas Oded Stark, qasja NELM e “ndryshon fokusin e teorisë së migrimit nga pavarësia individuale [...] në varësi të ndërsjellë” në nivelin familjar ose shtëpiak (Cassarino 2004, 256). Pavarësisht dallimeve dhe përparësive të tyre, Cassarino argumenton se të dyja qasjet kanë mangësi. Ndërsa ato përpiqen të shpjegojnë se kur dhe pse merret vendimi për t’u kthyer në atdhe, ato nuk e adresojnë çështjen se ku kthehen konkretisht të kthyerit apo cilat janë kushtet sociale, ekonomike dhe politike në vendin e origjinës. Qasja strukturore i adreson këto boshllëqe duke u fokusuar në procesin e kthimit përmes gjetjeve empirike dhe analizave teorike të antropologëve, sociologëve dhe gjeografëve socialë (Cassarino 2004, 257). Në të dyja qasjet, si në atë strukturore ashtu edhe në NELM, burimet financiare dhe ekonomike që sjellin migrantët në vendin e tyre të origjinës janë thelbësore për marrjen e vendimit për t’u kthyer si dhe për arritjen e riintegritimit pas kthimit. Suksesi apo dështimi i të kthyerve analizohet përmes lidhjes së realiteteve ekonomike dhe shoqërore të vendit të origjinës me pritshmëritë e tyre. George Gmelch (1980, 135–159) e zhvilloi më tej qasjen strukturore, duke e theksuar rëndësinë e qëllimeve të migrantëve të kthyer në përputhje me motivimet e tyre. Pavarësisht nëse këto qëllime janë reale apo të imagjinuara, ato e formësojnë mënyrën se si të kthyerit u qasen pritshmërive të tyre në vendin e origjinës.

Që nga fundi i viteve 1980, qasja transnacionale, e përqafuar nga shumë studiues të migrimit, është dëshmuar si një kornizë shumë e frytshme për të kuptuar situatën e

migrantëve. Përparësia e kornizës teorike transnacionale qëndron në fokusimin e saj qëndror në lidhjet ekonomike dhe shoqërore midis vendeve pritëse dhe atyre të origjinës së migrantëve, të cilat ekzistojnë në nivele të ndryshme. Ndryshe nga strukturalistët dhe përkrahësit e qasjes NELM, transnacionalizmi nuk e sheh kthimin si fund të ciklit migrator. Për ta, “kthimi i migrantëve është pjesë përbërëse e një sistemi qarkor të marrëdhënieve dhe shkëmbimeve shoqërore dhe ekonomike, i cili lehtëson riintegrimin e migrantëve, duke i përcjellë njohuritë, informacionet dhe përkatësinë” (Cassarino 2004, fq. 262). Si rrjedhojë, transnacionalistët e theksojnë përgatitjen e migrantëve para kthimit të tyre (p.sh., përmes vizitave, remitancave etj.). Vlen të theksohet se “qasja transnacionale ndaj migrimit të kthimit duket se përfshin iniciativat dhe projektet e tyre në atdhe në një grup të qëndrueshëm detyrimesh, mundësish dhe pritshmëri të ndërsjella që burojnë nga përkatësia e përbashkët etnike (p.sh. diaspora) dhe lidhjet familjare (p.sh. familja, shtëpia)” (Cassarino 2004, fq. 262–265).

Qasja tjetër, teoria e rrjetit shoqëror, ka dy ngjashmëri kryesore me qasjen transnacionale. Së pari, ajo i sheh “të kthyerit si bartës të burimeve materiale (të prekshme) dhe shpirtërore (të paprekshme)”, dhe së dyti, ajo “thekson rëndësinë e ruajtjes së lidhjeve të forta të tyre me vendin e origjinës dhe atë pritës” (Cassarino 2004, fq. 265–268).

### Parakushtet për kthim të suksesshëm

Këto korniza teorike dhe tipologji janë zgjeruar dhe zhvilluar më tej nga shumë studiues. Russell King dhe Katie Kuschmider vërejnë se “gjatë dy dekadave të fundit, [studimet për kthimin e migrantëve] janë zgjeruar në katër drejtime: 1. Zgjerimi i gamës gjeografike të kërkimeve për kthimin, 2. zgjerimi i konceptualizimit të kthimit, 3. politizimi në rritje i kthimit, dhe 4. efektet e kthimit të migrantëve (pas kthimit)” (2022, fq. 8).

Duke u mbështetur në përvoja të ndryshme nga vende të ndryshme të botës, këto tipologji dhe korniza teorike tregojnë se kthimi i migrantëve mund të ketë dallime të mëdha në rezultate. Ai mund të jetë i suksesshëm ose i pasuksesshëm, i dëshiruar ose i penduar, i nxitur nga rrethana familjare, apo të ndodhë pa shikëputje nga vendi pritës, e të ngjashme.

Duke u mbështetur në tipologjitë dhe kornizat teorike të migrimit të kthimit, Russell King nënvizon disa kushte që kontribuojnë në kthim të suksesshëm dhe rolin e tij në zhvillim. Ai e përkufizon zhvillimin, në kuptimin më të gjerë e më të zakonshëm, si *përmirësim të përgjithshëm të kushteve të jetesës* (2022, fq. 314), ndërsa migrimin e sheh si dëshirë dhe veprim për ta arritur këtë qëllim. Parakushtet për kthim të suksesshëm që kontribuojnë në zhvillim përfshijnë këto: Së pari, *vullnetin* e migrantit për t’u kthyer, i cili e bën vendimin të vullnetshëm, të marrë pa presione të jashtme, siç mund të jetë përfundimi i kontratës apo pamundësia për të fituar të drejtën e azilit. Kushti i dytë është *përgatitja*, ashtu siç diskutohet në elaborimin e Cassarino-s të qasjes transnacionale (2004, fq. 261–265). Përgatitja përfshin *dëshirën, gatishmërinë* (si: posedimi i kapitalit financiar, shkathtësive përkatëse dhe kontakteve shoqërore), si dhe *njohjen vlerësuese të migrantit për kushtet adekuate në vendin e origjinës*. Parakushti i tretë është *kohëzgjatja e qëndrimit* në vendin pritës dhe *mosha optimale* e të kthyerit në

momentin e kthimit. Cerase sugjeronte një qëndrim dhjetëvjeçar për sigurimin e kthimit të suksesshëm. Ndërsa, King argumenton se qëndrimi duhet të jetë mjaftueshëm i gjatë “për t’i mundësuar migrantit të grumbullojë kapital financiar, shoqëror e njerëzor si dhe të përthithë përvoja e vlera, por megjithatë mjaftueshëm i shkurtër që i kthyeri të ketë ende kohë dhe energji për të shfrytëzuar kapitalin, shkathtësitë dhe qëndrimet e fituara” (King 1986, fq. 19). Parakushti i fundit lidhet me *moshën*: të kthyerit duhet të jenë mjaftueshëm të moshuar për t’i mobilizuar burimet e tyre, por edhe mjaftueshëm të rinj për të ndjekur qëllimet dhe për të përdorur kapitalin e tyre në funksion të zhvillimit të vendit të origjinës (Lang et al. 2016, fq. 12, në King 2022, fq. 321).

### **Kthimi i migrantëve në zonat rurale në Kosovë**

Në rastin e Kosovës, për shkak të tensioneve politike disadekadëshe në ish-Jugosllavi, kthimi i migrantëve është bërë më i dukshëm vetëm pas luftës së vitit 1999, pas tërheqjes së forcave jugosllave nga Kosova (Kadriu 2022, fq. 98; Galloopeni 2017, fq. 18; Mustafa et al. 2007, fq. 27). Duke marrë parasysh që shumica e migrantëve janë nga zona rurale, nuk është befasisëse që kthimi ndodh shpesh në fshatrat e origjinës, pavarësisht trendit të vazhdueshëm të zbrazjes së këtyre zonave në Kosovë. Për shembull, ndërsa në vitin 2011, 61.7% e popullsisë jetonte në zona rurale, të dhënat më të fundit tregojnë se në fillim të vitit 2024, kjo përqindje kishte rënë në 50% (ASK Vjetari 2024, fq. 9; Raporti Digjital për Kosovën 2024). Kjo e bën përqendrimin në migrantët që kthehen në fshatrat e tyre veçanërisht të rëndësishëm, pasi kështu theksohet një rrjedhë e kundërt prej zbrazjes/shpopullimit të zonave rurale. Për më tepër, nëse zhvillimi rezulton i suksesshëm, ai mund të gjenerojë mundësi të reja dhe të krijojë vende pune. Ky hulumtim kontribuon gjithashtu në literaturën e kufizuar antropologjike për kthimin e migrantëve, e cila do ta ndihmonte përfytyrimin dhe kuptimin më të thellë të përvojave, motiveve, mendimeve dhe rezultateve të vendimit të të kthyerve – me fjalë të tjera, na mundëson të eksplorojmë historitë dhe rrëfimet e jetës së tyre (Kadriu 2022; Kadriu 2019).

Në literaturën ekzistuese për kthimin e migrantëve të shqiptarët e Kosovës shpesh trajtohet kjo temë brenda një konteksti më të gjerë migrator, siç është reduktimi i varfërisë (Vathi dhe Black, 2007), riintegrimi (Arenliu dhe Weine, 2016), apo synimi dhe/ose probabiliteti për t’u kthyer (Gashi dhe Adnett, 2015; Möllers et al. 2017; Kotorri 2017; Galloopeni 2017). Nga këndvështrimi antropologjik, këto qasje kanë disa kufizime. Së pari, të gjitha bazohen në të dhëna sasiore; së dyti, ato i adresojnë synimet dhe/apo probabilitetin për kthim e jo vetë kthimin; dhe së treti, të dhënat janë mbledhur ose përmes bisedave me emigrantë në vende të ndryshme pritëse, siç shihet në punën e Galloopenit (2017), ose përmes intervistave me kryefamiljarë në Kosovë që kanë dhënë përgjigje në emër të emigrantëve - anëtarë të familjeve të tyre, si në artikullin e Gashit dhe Adnett (2015). Kërkimet mbi riintegrimin fokusohen zakonisht te migrantët që janë dëbuar ose kthyer me detyrim. Edhe në rastet e kthimit të asistuar vullnetar, vullneti i lirë shpesh vihet në pikëpyetje, pasi këto raste zakonisht përfshijnë migrantë të targetuar që nuk kanë të drejtë ligjore për të qëndruar në vendin pritës. Për më tepër, asnjë nga këto studime nuk fokusohet në kthimin e vetëvullnetshëm të migrantëve apo ekskluzivisht në kthimin në zona rurale.

Kthimi i vullnetshëm në zonat rurale është vetëm një dimension i dinamikave demografike që ndodhin në këto zona, të cilat Caitriona Ní Laoire i përshkruan si një ripopullim të zonave rurale. Sipas Ní Laoire, “proceset e ripopullimit rural përfshijnë marrëdhënie të ndërlikuara midis migrimit të ri në fshatra, kthimit të migrantëve, vizitave të të larguarve, shtëpive të dyta (disa në pronësi të ish-banuesve ruralë), dhe, më e rëndësishmja, uljes së shkallës së emigrimit nga fshatrat” (2007, fq. 332–344). Në fshatrat e Kosovës mund të vërehen të gjitha këto nuanca të ripopullimit rural, pavarësisht trendit të vazhdueshëm të emigrimit. Përveç kthimit të pensionimit ose kthimit për bashkim familjar apo investime, është e dukshme edhe një formë e re e imigrimi në fshat, e nxitur nga ndryshimet në stilin e jetesës, si për shembull ndërtimi i shtëpive të dyta. Këto shtëpi të dyta mund të ndërtohen qoftë nga pronarë të rinj që blejnë tokë individualisht, qoftë nga kompani si pjesë e projekteve turistike. Megjithatë, kjo e fundit është një temë që kërkon hulumtim të mëtejshëm.

Ky punim është një përpjekje modeste për të adresuar mungesën e literaturës akademike për kthimin e migrantëve, ndërmarrësinë dhe zhvillimin në Kosovën rurale përmes prezantimit të përvojave të tri rasteve të diskutuara.

### **Bletë, lepuj apo pemë: Themelimi i biznesit pas kthimit si një ëndërr e bërë realitet**

Shyqa është kultivues dhe prodhues bimësh. I lindur në vitin 1970 në një fshat në qendër të Kosovës, ai emigroi në Gjermani në vitin 1986, në moshën 16-vjeçare. Ai kishte përvojë në punët bujqësore dhe disa njohuri për shartimin e bimëve, të cilat i kishte mësuar nga xhaxhai i tij. Gjetja e një pune në vendin pritës për të nuk ishte e vështirë, pasi një vëlla i tij më i madh tashmë ndodhej atje dhe punonte. Së bashku ata punuan edhe në një kompani që merrej me pllaka, edhe në një fidanishte, *Baumschule*. Në këtë të fundit, kultivonin bimë të blera diku tjetër; nuk prodhonin apo shartonin e shumonin bimë vetë. Këto punë Shyqës i erdhën natyrshëm dhe ai vazhdoi t’i punonte të dyja punët për 14 vjet. Edhe pse nuk përjetoi ngritje të statusit shoqëror, gjatë qëndrimit në Gjermani, ai grumbulloi kapital financiar dhe njerëzor, përfshirë kursimet dhe shkathtësitë e përforcuara.

Në vitin 2000, Shyqa la vëllain e martuar dhe familjen e tij në Gjermani dhe u kthye në familjen e tij të madhe në Kosovë, e cila përbëhej nga prindërit dhe tre vëllezër të martuar (tri motrat më të mëdha se ai tashmë ishin të martuara dhe jetonin diku tjetër). Para se të kthehej, ai dhe vëllai i tij në Gjermani diskutuan se cili nga ta duhet të kthehej. Shyqa tha se vendosi të kthehej sepse ishte beqar dhe dëshironte të martohej, ndërsa për vëllain e martuar me fëmijë ishte më i sigurt qëndrimi në Gjermani. Kështu, motivimi i tij për kthim ishte ribashkimi me familjen, krijimi i një familjeje të re dhe themelimi i një biznesi, sepse ekzistonte shpresë e madhe që Kosova do të lulëzonte pas luftës. Ai tha: “Mendonim se do ta bëjmë Kosovën Zvicër pas çlirimit [...] dhe e kishim ëndërr të hapnim një biznes kur të kthehemi”. Pas kthimit, Shyqa, së bashku me një nga vëllezërit që jetonte në Kosovë, me financat e kursyera prej tij dhe vëllait në Gjermani, vendosën të nisnin një biznes së bashku. Ai i konsideroi tri ide: kultivimin e bletëve, rritjen e lepujve dhe themelimin e një fidanishteje për bimë dhe lloje të ndryshme pemësh. E zgjodhi opsionin e tretë, duke menduar se do të ishte më i thjeshtë,

por rezultoi të jetë mjaft sfidues, pasi bimëve dhe pemëve u duhet shumë kohë për t'u rritur. Ai e kishte mësuar shartimin nga xhaxhai dhe më pas e kishte përmirësuar shkathtësinë e tij për kultivimin e bimëve përmes studimit të librave të ndryshëm, edhe pse nuk kishte ndjekur ndonjë kurs formal. Për këtë biznes e përdorën tokën familjare që babai i tij e kishte blerë shumë kohë më parë. Në vitin 2009, familja e madhe u nda. Vëllai i tij më i vogël vazhdoi me të në këtë nismë ndërmarrësie. Sot, edhe pse jetojnë në shtëpi të ndara dhe i menaxhojnë shpenzimet e tyre individualisht, e gjithë pasuria tjetër, përfshirë tokën dhe kompaninë, mbetet pronë e përbashkët.

Biznesi u rrit ngadalë, por në mënyrë të qëndrueshme. Sot, kompania e tyre ka gjashtëmbëdhjetë punëtorë të rregullt dhe djali i motrës së Shyqës është tani menaxher. Nipi i tij më parë studionte dhe punonte gjatë verës, dhe shpesh ftonte miq e shokë studentë për të punuar në kompani gjatë kësaj sezone. Me kalimin e kohës, shumë nga këta studentë i përfunduan studimet, e disa prej tyre kanë emigruar dhe siguruar punë profesionale në vende të ndryshme. Shyqa e përmendi këtë arritje si kontribut jo vetëm për familjen, por edhe për zhvillimin shoqëror, duke treguar se si kapitali social ndërtohet vazhdimisht, krahas lidhjeve familjare.



Figura 1. Zyrat e fidanishtes. Foto nga autorja

Një shkallë e zhvillimit është e dukshme në faktin se kompania e tij eksporton me sukses bimë dhe pemë jashtë Kosovës, përfshirë në Itali dhe Holandë. Bashkëpunimi është bërë shumë më i lehtë që kur djali i tij 20-vjeçar iu bashkua. Djali është student në një universitet në Prishtinë, ku ndjek studimet në Menaxhim, biznes dhe ekonomi.

Njohja e tij shumë e mirë e anglishtes e ka lehtësuar ndjeshëm punën e tyre. Ngritja e statusit shoqëror të tij që nga kthimi është i dukshëm – ai ka një shtëpi të re, toka të reja dhe është pronar biznesi – dhe kontributi në ngritjen e statusit social të brezave pasardhës duket premtues. Nga një punëtor me kualifikim të ulët të shkathësive në Gjermani, ai është bërë menaxher i të vetmes fidanishte në rajon që kultivon bimë, duke i mbjellë, shartuar dhe kujdesur për to me vite. Ai ndihet krenar për punën e tij, duke theksuar se ndërsa kompani të tjera vetëm tregtojnë me bimë, ata i kultivojnë vetë. I pyetur për vlerën e përvojës së tij të marrë në Gjermani, ai theksoi se mësimet më të rëndësishme ishin etika e punës që e kishte zhvilluar, qasja ndaj klientëve dhe kalimi nga një stil jetese i përqendruar në takime të gjata familjare e shoqërore, drejt përkushtimit ndaj punës. Ai e konsideron ndërmarrjen e tij si shumë inovative për shkak të lidhjeve transnacionale dhe bashkëpunimit që ka krijuar me kompani italiane dhe holandeze. Ngritja e statusit të tij shoqëror është e dukshme kur reflekton mbi faktin që ai ka nisur gjithçka nga e para dhe, përmes punës së palodhshme dhe këmbënguljes, ka arritur të bëhet pronar i një ndërmarrjeje.



Figura 2. Parcela e fidanishtes me fidane të ndryshme. Foto nga autorja.

### **Nëse (këtë punë) po e bëj këtu, pse të mos e bëj atje?**

Dema lindi në vitin 1961 në një familje bujqësore në një fshat piktoresk malor të tipit me shtëpi të shpërndara. Familja e tij përbëhej nga prindërit, katër vëllezërit dhe dy motrat. Në vitet 1980, Dema dhe dy nga vëllezërit e tij ishin studentë në Universitetin e Prishtinës kur filluan trazirat politike në Kosovë dhe ata u përfshinë në lëvizjet studentore. Për shkak të pasigurisë së rritur politike dhe ekonomike, Dema emigroi në Zvicër në vitin 1987, një vëlla i shkoi në Gjermani, kurse vëllai më i madh dhe ai më i vogël qëndruan në shtëpi. Në Zvicër, gjeti punë në arat e një profesori universitar që merrej me prodhime bio. Pikërisht ai, për herë të parë, u njoh me konceptin e prodhimeve bio, i cili sapo kishte filluar të përhapej në Zvicër. Duke qenë se kishte punuar në arat e familjes dhe ishte kujdesur për bagëtinë, Dema u tregua një punëtor i shkëlqyer. Siç ndodh shpesh me migrantët, Dema mori edhe punë shtesë. Pas disa vjetësh në Zvicër, u martua me një grua shqiptare nga Kosova. Ajo filloi punë në kuzhinat e restoranteve atje. Çifti ka dy fëmijë: një vajzë dhe një djalë.

Në vitin 1999, menjëherë pas luftës, ai e nisi procesin e kthimit duke dërguar gruan dhe fëmijët në shtëpi, pa e imagjinuar se ai do të mbetej migrant deri në vitin 2011, plot 24 vjet pas emigrimit. Meqë shtëpitë e familjes në fshat ishin shkatërruar nga bombardimet serbe, ata ndërtuan një shtëpi të re ku u strehuan prindërit e Demës, dy vëllezërit me familjet e tyre dhe gruaja e Demës me fëmijët. Ai vendosi të kthehej pasi mësoi për përfitimet e produkteve bio, veçanërisht të vezëve, dhe të ardhmen premtuese që shkencëtarët zviceranë parashikonin për këto produkte. Siç e shpjegon ai:

“Një ditë po shikoja televizor dhe duke dëgjuar lajmet vura re se po tregonin rezultatet e një ankete për produktin më të preferuar të njerëzve. ‘Vezët bio’ ishin në vendin e parë. Dëgjova me vëmendje për përfitimet ekonomike dhe shëndetësore të produkteve bio. Dhe atëherë më erdhi mendimi: ‘U kry. Kjo është ajo që më duhet. Do të kthehem në vendlindje dhe do ta bëj më të mirën për vendin dhe popullin tim. Nëse po e bëj këtu, pse të mos e bëj atje?’”

Pas kthimit, ndërtoi një fermë pulash ku fillimisht mbante 200 pula, duke respektuar të gjitha standardet për prodhimin e vezëve bio. Kjo pati ndikim pozitiv jo vetëm për familjen e tij të ngushtë, por edhe për vëllezërit që jetonin aty afër me të cilët në disa aspekte, së bashku, ende funksionojnë si familje e madhe. Sot, katër vëllezërit kanë secili shtëpinë e vet dhe jetojnë veçmas, por punojnë së bashku në sektorë të ndryshëm. Ata drejojnë një kompani të produkteve bio dhe, përveç vezëve bio, shesin mjaltë nga bletaria (njëri nga vëllezërit ka 50 koshere), si dhe reçel, turshi, ajvar dhe produkte të tjera të përgatitura nga fruta (molla, kumbulla, dardha dhe mana të ndryshme) dhe perime, të gjitha të kultivuara pa pesticide. Gjithashtu prodhojnë djathë dhe produkte të qumështit nga lopët e tyre. Vëllai më i vogël ende jeton në Gjermani, por vazhdon të dërgojë remitanca.

Kthimi i tij ka pasur ndikim pozitiv përtej familjes së tij, duke zgjeruar kufijtë e ndikimit dhe duke rritur nivelin e zhvillimit. Me kalimin e kohës, numri i pulave u rrit, duke e detyruar atë të siguronte kotece dhe pika grumbullimi të reja, nga të cilat kanë përfituar edhe fshatarët e tjerë (tani ka rreth 6000 pula). Përveç marrjes me qira të tokës

për kotece dhe ushqyerje të pulave, ai përfshiu në ndërmarrje disa familje me status të ulët socio-ekonomik, duke u ndihmuar atyre që të përmirësojnë cilësinë e mbajtjes së fermave për lopë dhe pula, gjithmonë duke ruajtur standardet për prodhimin e djathit dhe vezëve bio. Ai shpërndan vezë në rreth 200 tregje në të gjithë Kosovën dhe dërgon produkte bio të familjes të klientë të pasur në Prishtinë.



Figura 3. Ferma e pulave. Foto nga autorja

Inovacioni i tij nuk ndalet me kaq. Për gati dhjetë vjetësh, ai ka menaxhuar gjithashtu një restorant në katin e parë të shtëpisë së tij, me pamje mahnitëse nga malet dhe qielli. Krahas gatimeve tradicionale vendore, restoranti ofron edhe ushqime zvicerane të përgatitura nga gruaja e tij, e cila i ka mësuar ato gjatë qëndrimit të tyre në Zvicër. Ngjitur me restorantin, ai ka hapur një “Hofladen” (një term gjerman që do të thotë dyqan ferme), ku i shet produktet bio të familjes së tij. Një tavolinë e madhe në *hofladen*

është e mbuluar me fotografi të shumta të mysafirëve të shquar që kanë darkuar atje, përfshirë ambasadorë, politikanë nga Kosova dhe bota, përfaqësues të Bankës Botërore dhe shumë të tjerë. Menuja kushton 25 euro, duke përfshirë verë dhe raki. Edhe pse është më e shtrenjtë se në vende të tjera, ai e shpjegon kështu:

“Ja vlen, sepse kur vijnë këtu, ndihen sikur kanë marrë një fluturim dhe kanë arritur në Alpet Zvicerane, jo vetëm për shkak të ushqimeve, por edhe për pamjen e bukur që shohin nga dritarja, drejtpërdrejt mbi male.”



Figura 4. Pamja nga restoranti. Foto nga autorja.  
Figura 5. *Hofladen*. Foto nga autorja.



Figura 5. *Hofladen*. Foto nga autorja.

Idetë dhe agjencia e tij për zhvillim shprehen përmes nismave të reja. Duke e njohur bukurinë e fshatit dhe potencialin e tij për të tërhequr turistë, planifikon ta zgjerojë biznesin duke ofruar dhoma me qira. Edhe me më rëndësi duket ideja që, në bashkëpunim me fermerë të tjerë, të themelojë një shoqatë me qëllim që të adresojnë nevojat e përbashkëta të ministritë përkatëse. Për më tepër, i pakënaqur me donacionet dhe subvencionet që ofron shteti për ndërmarrësit, ai është në negociata me fermerë të tjerë për të hapur një bankë, me qëllim arritjen e pavarësisë.



Figura 6. Produktet që shiten në *hofladen*. Foto nga autorja.

Falë inovacionit të tij dhe statusit të ri shoqëror, ai beson se është bërë një konkurrent i fortë në treg për dy marka ndërkombëtare të vezëve, një nga Italia dhe tjetra nga Turqia. Me krenari tregon se mënyrat e tij të prodhimit kanë tërhequr vizita nga ekspertë të huaj dhe studentë të universitetit shtetëror. Mobiliteti i tij shoqëror dhe kënaqësia nga suksesi i arritur, sidomos në krahasim me jetën si emigrant, bëhen të dukshme kur ai thotë:

“Ndihehem shumë krenar, sepse ata që më thanë se nuk do të kisha sukses, se nuk do të mund të shisja, dhe se shumë produkte nuk do të rriteshin në fshatin tim pa pesticide, dolën të qenë gabim [...] Në Zvicër isha njeri anonim. Sot më vizitojnë ambasadorë, profesorë, politikanë dhe njerëz të tjerë të shquar.”

### **Shkuan si furrhtarë, kthehen si prodhues vere**

Rasti i tretë, që përfshin Lukën, shfaq modele të tjera të migrimit, veprimit dhe negocimit. Familja e Lukës vjen nga një fshat afër komunës së Prizrenit, që ndodhet në krahinën etnografike të Hasit, në jugperëndim të Kosovës. Kjo zonë është e njohur për historinë e saj të gjatë të migrimit, sidomos të burrave, të cilët kanë punuar si furrhtarë në të gjithë rajonin. Ndërkohë, ata që qëndronin në vendlindje, punonin në arat familjare duke kultivuar drithëra dhe perime të ndryshme. Luka ka shtatë motra e vëllezër – katër vëllezër dhe tri motra. Ai është djali i madh, i lindur në vitin 1975, ndërsa vëllai më i vogël ka lindur në vitin 1985.

Pesë gjenerata të kësaj familjeje kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë jashtë vendit si furrhtarë në vende të ndryshme. Filluan në Rahovec, pastaj u shpërngulën në Serbi, ku gjyshi i Lukës dhe gjeneratat më të hershme punuan për dekada. Më pas, ata u zhvendosën në Vojvodinë, ku i ati i Lukës, Isa, dhe xhaxhai Hasani u vendosën në vitin 1964. Luka iu bashkua atyre në Vojvodinë në moshën 15-vjeçare. Gradualisht, deri në vitin 2000, të gjithë vëllezërit dhe familjet e tyre të ngushta ishin bërë bashkë atje. Pastaj Luka punoi në Rumani nga viti 2008 deri në vitin 2019, pa vëllezërit e tij. Më vonë, ata u shpërngulën në Sllovaki. Vëllai i tretë i tij u shpërngul i pari në qytetin Shamorin, ndërsa Luka u vendos në Bratislavë, ku iu bashkuan edhe tre vëllezërit e tjerë. Aktualisht, Luka dhe Xhema punojnë së bashku në një furrë, ndërsa Ahmeti dhe Nebiu menaxhojnë një tjetër. Refiku zgjodhi të punojë në mënyrë të pavarur në Shamorin.

Është me rëndësi të theksohet se Luka dhe vëllezërit e tij, si shumë familje të zonave rurale të Kosovës, shfaqin elemente të forta të strukturës tradicionale të familjes së madhe. Këto elemente ishin të dukshme edhe në rastin e Demës. Më parë i jam referuar rasteve të tilla si familje të zgjeruara transnacionale, të karakterizuara nga madhësia e madhe e familjeve të shqiptarëve të Kosovës dhe solidariteti unik që shtrihet edhe te xhaxhallarët (Kadriu 2018, 173–193). Sipas Deborah Fahy Bryceson dhe Ulla Vuorela, “familjet transnacionale [...] janë familjet që jetojnë ca kohë apo të shumtën e kohës të ndara nga njëra-tjetra, megjithatë mbahen së bashku dhe krijojnë diçka që mund të shihet si mirëqenie kolektive dhe unitet, d.m.th. ‘familjari’, madje edhe përtej kufijve” (Fahy Bryceson & Vuorela 2002, 3). Ky fenomen, i kombinuar me ndjenjën e përkatësisë dhe lidhjes me vendlindjen, zbulon kufij simbolikë komunitarë në një

shkallë të madhe.

Edhe pse në vitin 2000 të gjithë vëllezërit jetonin jashtë vendit të origjinës, lidhjet me vendlindjen ishin ruajtur. Kjo për faktin se që nga viti 1992, Isa, babai i tyre, ishte kthyer në fshat dhe jetonte atje me nënën e tyre. Pozita e tyre socio-ekonomike në vendin pritës kishte mbetur e pandryshuar për gjenerata. Megjithatë, në fshatin e tyre kjo filloi të ndryshonte, fillimisht me blerjen e tokës dhe më vonë me ndërtimin e një shtëpie të re familjare në vitin 2002. Edhe pse jetonin kryesisht në mënyrë transnacionale, Luka dhe vëllezërit e tij gjithmonë kishin synuar – dhe ende planifikojnë – të kthehen përfundimisht një ditë. Hapi i parë u ndërmor nga Luka në vitin 2007, kur gruaja dhe tre fëmijët e tij u kthyen në fshat, edhe pse ai vazhdoi të punonte jashtë. Së shpejti, Xhema bëri të njëjtën gjë. Motivimi kryesor për kthimin e grave dhe të fëmijëve ishte parandalimi i asimilimit të fëmijëve në vendin pritës. Ata punojnë në çifte, sepse kjo është më e përshtatshme për menaxhimin e biznesit. Lukës dhe Xhemës, kjo marrëveshje u mundëson gjithashtu vizita dhe kujdes për familjet e tyre të ngushta, si dhe nënën që jeton në Kosovë (babai i tyre vdiq në vitin 2015). Ata qëndrojnë me radhë në shtëpi nga tre muaj secili. Vëllezërit e tjerë jetojnë me familjet e tyre të ngushta në qytete të huaja dhe vizitojnë vendlindjen gjatë pushimeve verore ose në raste të veçanta. Megjithatë, të pestë mendojnë dhe veprojnë ende si një familje e përbashkët, veçanërisht sa i përket pronës së përbashkët në fshat, duke ruajtur kështu identitetin e tyre si familje e zgjeruar transnacionale.

Si një familje kryesisht transnacionale, por gjithmonë me kthimin dhe lidhjen me vendlindjen në mendje, ngritja e statusit shoqëror të tyre u bë e dukshme në vitin 2013. Atë vit, filluan ndërtimin e shtëpive të veçanta, por të njëjta, në të njëjtin oborr, nëpër të cilat u ndanë në vitin 2018, kur ndërtimi i tyre përfundoi. Ato janë shtëpi të bukura, të mëdha, moderne, të rrethuara me oborre të rregulluara. Ato simbolizojnë vlera tradicionale si barazia, vëllazëria dhe uniteti familjar, duke e reflektuar njëkohësisht suksesin dhe modernizimin. Grumbullimi i remitancave financiare dhe investimet e përbashkëta konkretizojnë kufijtë simbolikë të përkatësisë familjare. Në diskursin publik, siç ndodh shpesh me migrantët, kjo shprehje simbolike ngrihet në nocione të përkatësisë etnike, kombëtare apo kulturore.



Figura 7. Arë e mbjellë me rrush të zi serezi (currant). Foto nga autorja.

Një dekadë më vonë, në vitin 2023, Luka dhe vëllezërit e tij ndërmorën një hap të rëndësishëm në udhëtimin e tyre transnacional duke shfrytëzuar rrjetin e zgjeruar social. Pasi krijuan një marrëdhënie kuptimplote me Salën, një teknolog vere shqiptar nga Maqedonia e Veriut, dhe punëdhënësin e tij – pronar i një fabrike vere në Sllovaki – ata vendosën të investojnë në një projekt të madh të përbashkët që do t'u mundësonte të kapërcenin shumë kufij. Themeluan një fabrikë vere nga rrushi i zi i serezi. Toka që babai i tyre kishte blerë dekada më parë, e cila më parë ishte mbjellë me misër, grurë dhe drithëra të tjera të zakonshme, tani është mbjellë me rrush serezi. Gjatë viteve të fundit, ata nuk e kishin shfrytëzuar vetë këtë tokë, por ia kishin dhënë hua falas një fshatari, thjesht për të mos e lënë djerrë. Themelimi i objektit të fabrikës u përurua në qershor, me pajtimin e të gjithë vëllezërve që e mendonin si një mundësi të vlefshme. Kjo ndërmarrje u ofron të gjithëve motivim për t'u kthyer përfundimisht në atdhe.



Figura 8. Themelet e fabrikës së verës nga rrushi i zi. Foto nga autorja.

Një shkallë e zhvillimit dhe ngritjes së statusit shoqëror pritet me funksionalizimin e fabrikës së verës. Kjo do të përfshijë ndryshimin e profesionit, përgjegjësitë menaxheriale dhe mundësitë e punësimit që do të ndikojnë jo vetëm në familjen e tyre, por edhe në komunitetin e fshatit. Kjo tregon nevojën për një rrjet të gjerë profesionistësh për funksionalizimin e fabrikës, përfshirë ndërmarrës nga jashtë, arkitektë, kompani ndërtimi, si dhe ekspertë të verës nga Kosova.

Rastet e paraqitura në këtë punim ofrojnë njohuri të vlefshme për përvojat e emigrantëve me kualifikim të ulët profesional (pa arsim të lartë në këto profesione). Pavarësisht mungesës së kualifikimeve formale, agjencia (aftësia për të vepruar) e tyre inovative dhe idetë rezultuan të suksesshme për shkak të faktorëve të tjerë të identifikuar si parakushte për kthim të suksesshëm, si: gatishmëria, përgatitja, kohëzgjatja e qëndrimit në vendin pritës, mosha si dhe akumulimi i mjaftueshëm i kapitalit financiar, shoqëror dhe njerëzor. Ekzistojnë gjithashtu shembuj të emigrantëve me arsim të lartë që kthehen në zonat rurale të Kosovës, ndikimi zhvillimor i të cilëve mund të jetë më i madh – ose jo – dhe që padyshim kërkojnë hulumtim të mëtejshëm.

Secila nga përvojat e përshkruara më sipër është unike, por ato kanë disa të përbashkëta. Në të gjitha rastet, është i dukshëm funksionimi brenda një familjeje të madhe, që përfaqëson nocionin dhe karakteristikat e një familjeje transnacionale si një faktor që ndihmon përgatitjen dhe ruajtjen e rrjeteve shoqërore dhe lidhjeve me atdheun. Rasti i tretë paraqitet veçanërisht i dallueshëm, pasi thekson jo vetëm lidhjet e forta familjare, por edhe një rrjet shoqëror transnacional dhe ndikimin e tij në ide të reja, inovacion dhe zhvillim. Kjo gjithashtu dëshmon se, në njëfarë mënyre, zhvillimi është arritur duke i ruajtur njëkohësisht vlerat tradicionale. Në përgjithësi, në të tria rastet, të kthyerit kanë përjetuar ngritje të statusit shoqëror, sidomos sa i përket cilësisë së jetës dhe mirëqenies. Zhvillim domethënës dhe ngritja e statusit në aspektin e zhvillimit kulturor (p.sh. arsimim universitar) vërehet te brezi i dytë, duke treguar për investim të vazhdueshëm dhe mëtejme në ndryshim statusor. Nga perspektiva gjinore, gratë (bashkëshortet) gjithnjë e më shumë marrin pjesë në ndërmarrësi. Megjithatë, në kontekstin rural, ato vazhdojnë të kryejnë detyra tradicionale si gatimi dhe përgatitja e produkteve të qumështit - bulmetit.

Mungesa e rolit vendimmarrës të grave të emigrantëve në lidhje me kthimin është e dukshme në rastet e Demës dhe Lukës. Megjithatë, barazia gjinore në zonat rurale është vërejtur gjatë hulumtimit në një fshat tjetër të rajonit të Rugovës, ku një çift i kthyer me fëmijët e tyre themeloi një motel. Çifti përgatit ushqime tradicionale, jep dhoma me qira dhe kontribuon në zhvillimin e turizmit të rajonit. Progresi në përmirësimin e rolit dhe pozitës së gruas mund të pritët në brezat më të rinj, siç janë fëmijët e emigrantëve. Kjo vërehet nga fakti që vajza e Lukës ka përfunduar studimet universitare dhe aktualisht punon si edukatore në një institucion parashkollor në një qytet të afërt. Po ashtu, vajza e Demës ka diplomuar në Matematikë dhe është e punësuar.

Në dy rastet e para, të cilat mund të konsiderohen si raste të konsoliduara të kthimit, bashkëbiseduesit theksuan dhe zbuluan disa sfida me të cilat përballen si ndërmarrës. Një nga shqetësimet e tyre ishte mungesa e mbështetjes së mjaftueshme nga ana e shtetit, ndonëse pranuan se kohë pas kohe kishin marrë ndonjë grant. Megjithatë, ata argumentuan se kontributi i tyre për shtetin përmes tatimeve mbështet zhvillimin e përgjithshëm, dhe për këtë arsye, ndërmarrësia e tyre duhet të inkurajohet dhe mbështetet më shumë. Dëma shpjegoi se si disa rregullore e vështirësojnë qasjen në subvencione a grante dhe e pengojnë zhvillimin:

“Nëse marrim donacione/grante, nuk mund të kërkojmë kredi bankare. Nëse aplikojmë për kredi, nuk na lejohet të kërkojmë donacione/grante. Duke marrë parasysh nivelin e ulët të përkrahjes, taksat e larta dhe kërkesat monetare të

mëdha nga dyqanet/marketet për shitjen e produkteve, shihet se ne po përballemi me barrë të rëndë.”

Në të tria rastet, nga bisedat u zbulua se disa remitanca të caktuara shoqërore janë sjellë nga vendet pritëse. Sipas Peggy Levitt-it, “remitancat shoqërore janë idetë, sjelljet, identitetet dhe kapitali shoqëror që migrantët eksportojnë në komunitetet e tyre të origjinës. Ato përfshijnë ide rreth demokracisë, shëndetit dhe organizimit komunitar” (2004, fq. 6). Në këtë kontekst, të gjithë e theksuan etikën e punës, përpikërinë dhe komunikimin me palët e dyta dhe të treta si përvojat më të rëndësishme të fituara në vendet pritëse. Interesant është fakti që në dy rastet e para, shartimi dhe prodhimi bio mund të interpretohen si përparime moderne të praktikave tradicionale, të përshtatura për të qenë në përputhje me prirjet e reja të konsumatorëve, duke shënuar kështu edhe një zhvillim shoqëror dhe ekonomik. Idetë për themelimin e një shoqate fermerësh dhe një banke përfaqësojnë inovacione konkrete që lidhen me demokracinë dhe organizimin komunitar. Themelimi i fabrikës së verës, edhe pse në fazë të hershme, pritet të ketë ndikim të rëndësishëm si në fshat, ashtu edhe në vend. Para pak kohësh e kam kontaktuar Lukën (2024) dhe u gëzova shumë kur dëgjova se pemët e mbjella po lulëzojnë në tokën e tyre.

Pavarësisht vështirësive dhe sfidave me të cilat u përballën këta të kthyer gjatë kthimit dhe themelimit të bizneseve, kur u pyetën nëse ishin penduar për vendimin për t’u kthyer, përgjigjja ishte një ‘jo’ e vendosur. Arsyeja e tyre shpesh përfshinte ndjenja patriotike dhe dashuri të thellë për familjen, komunitetin dhe atdheun. Kjo shërben si dëshmi se vendosmëria dhe gatishmëria për t’u kthyer udhëheq dhe inkurajon përpjekjet e tyre të vazhdueshme për zhvillim personal, familjar dhe komunitar, si dhe për realizimin e qëllimit të tyre për ta bërë atdheun një vend më të mirë.

## **Përfundim**

Fenomeni i kthimit të vullnetshëm të migrantëve është vërejtur që nga përfundimi i luftës në vitin 1999. Kjo ndodhi kryesisht për shkak të lirisë së pritur të atdheut dhe pritshmërive të larta që e shoqëruan situatën e re politike. Kjo situatë dhe ndjenjë e siguri për shqiptarët e Kosovës ofroi një parakusht të qëndrueshëm të cilin Amartya Sen e përshkruan si “*mundësi* (capability) të njerëzve që të kontrollojnë jetën e tyre dhe të kenë qasje në burimet kyçe për një jetë të këndshme dhe të kënaqshme”, gjë që çon në zhvillim. (Amartya Sen 1999, në King 2022, fq. 315)

Për Shyqën dhe Dullën, viti 1999 ishte një vit kur e fituan mundësinë për ta marrë kontrollin mbi veprimet e tyre dhe për ta realizuar dëshirën për kthim. Ishte një vit kur, siç theksohet në qasjen strukturore, “realiteti ekonomik dhe shoqëror në vend” ishte i favorshëm për ta; po ashtu ishte një vit kur, në përputhje me teorinë e Ekonomisë së Re të Migrimit të Punës, “strategjitë e tyre të kalkuluara” mund të realizoheshin. Vullneti, motivimi dhe gatishmëria e Shyqës për t’u martuar dhe për të hapur një biznes ishin të menjëhershme, ndërsa “përgatitja” e Dullës kërkoi edhe disa vite të tjera.

Këto dy raste shfaqin më pak elemente të qasjes transnacionale, pasi kthimi i tyre duket më shumë si “përfundim i ciklit” të migrimit. Megjithatë, biznesi i Shyqës po bëhet transnacional për shkak të eksportit të produkteve të tij, ndërsa restoranti i

Dullës po shndërrohet në një hapësirë simbolike “transnacionale” ku Zvicra mund të “shijohet” përmes ushqimeve zvicerane, peizazhit malor dhe klientelës ndërkombëtare. Në rastin e Lukës, elementet e qasjeve transnacionale dhe të rrjetit shoqëror janë më të theksuara. Kjo për faktin se ata jetojnë si një familje transnacionale në disa vende pritëse, ndërkohë që investojnë së bashku në të njëjtën ndërmarrje, duke shfrytëzuar rrjetin e tyre shoqëror për ta mbështetur biznesin. Ndikimi i ndërmarrësisë së tyre në zhvillimin familjar dhe komunitar është premtues, edhe pse ende në zhvillim e sipër.

Literatura ndërkombëtare për kthimin e migrantëve sugjeron se kthimi në zonat rurale shpesh ka ndikim të kufizuar zhvillimor për dy arsye: e para, të kthyerit zakonisht kanë profil të ulët kualifikues; dhe e dyta, zonat rurale ofrojnë mundësi të kufizuara dhe karakterizohen shpesh nga komunitete të mbyllura, konservatore dhe patriarkale. Megjithatë, këto studime të rasteve tregojnë se kthimi në zonat rurale mund të çojë në sukses, zhvillim lokal e shtetëror dhe ngritje të statusit shoqëror të migrantëve, familjeve të tyre dhe komuniteteve – duke kontribuar përfundimisht në mirëqenien e përgjithshme.

## FUNDNOTAT

1 Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore nga viti 2007, 70 për qind e migrantëve nga Kosova kanë prejardhje nga zonat rurale (Möllers et al. 2017, fq. 13).

2 Në shumë biseda me migrantë, u zbulua se, përveç investimeve në fshatrat e tyre, ata gjithashtu blejnë banesa në qytetin më të afërt nga fshati ose në kryeqytet, Prishtinë, duke u bërë kështu multilokalë. Carolin Leutloff-Grandits ka vërejtur një fenomen të ngjashëm të migrantët në rajonin e Opojës në Kosovë dhe e ka shpjeguar këtë si një nevojë për t’u distancuar nga kontrolli social i jetës në fshat. Ky model është vërejtur gjithashtu edhe në vende të tjera (Farrell et al. 2012, fq. 31–44; Hagan dhe Wassink 2019).

3 Tema ime e doktoratës, me titull “Çështje familjare gjatë pushimeve: Praktikimi i pushimeve dhe ruajtja e lidhjeve familjare në diasporën shqiptare të Kosovës”, u mbrojt më 28 nëntor 2016. Shumë migrantë takova gjithashtu gjatë projektit me titull “Atlasi etnografik i fshatit në Kosovë”, i cili u realizua në vitin 2023 nga Instituti Albanologjik në Prishtinë, përkatësisht nga dy departamentet e tij: Etnologji dhe Folklor. Si rezultat, u vizituan 18 fshatra anëmbanë Kosovës dhe u regjistruan 80 intervista. Disa nga të intervistuarit ishin migrantë të kthyer.

## BIBLIOGRAFIA

- Arenliu, Aliriza, and Stevan M. Weiner. 2016. “Reintegrating Returned Migrants to Kosovo.” *Psychological Research*, 19 (1): 61-73
- Battistella, Graziano. 2018. *Return Migration: A Conceptual and Policy Framework*. Rome: Scalabrini Migration Center.
- Bivand-Erdal, Marta, and Ceri Oeppen. 2022. “Theorising Voluntariness in Return.” In *Handbook of Return Migration*, edited by Russell King and Katie Kuschminder, 70–83. Cheltenham: Elgar Publishing.
- Bonvenkerk, Frank. 1974. *The Sociology of Return Migration: A Bibliographic Essay*.

- The Hague: Nijhoff.
- Cassarino, Jean-Pierre. 2004. "Theorising Return Migration: The Conceptual Approach to Return Migrants Revisited." *International Journal on Multicultural Societies* 6 (2): 253–79.
- Cerese, Francesco. 1967. "A Study of Italian Migrants Returning from the U.S.A." *International Migration Review* 1 (3): 67–74.
- Čapo, Jasna. 2024. "Introduction: Meandering Through Return Migration and Its Effects." In *Return Migration and Its Consequences in Southeast Europe*, edited by Jasna Čapo, Rozita Dimova, and Lumnije Jusufi, 11–33 (47). Berlin: Peter Lang.
- Fahy Bryceson, Deborah, and Ulla Vuorela. 2002. "Transnational Families in the Twenty-First Century." In *The Transnational Family: New European Frontiers and Global Networks*, edited by Deborah Fahy Bryceson and Ulla Vuorela, 3–18. Oxford: Berg.
- Farrell, Maura, Marie Mahon, and John McDonagh. 2012. "The Rural as a Return Migration Destination." *European Countryside* 1: 31–44. <https://doi.org/10.2478/v10091-012-0012-9>.
- Gallopeni, Besim. 2016. "Kosovar Emigration: Causes, Losses and Benefits." *Sociologija i Prostor* 54 (3): 295–314.
- Gallopeni, Besim. 2017. "Kthimi i Emigrantëve Kosovar në Kosovë: Mit apo Realitet." *Social Studies* 11 (2): 17–34.
- Gashi, Ardiana, and Nick Adnett. 2015. "The Determinants of Return Migration: Evidence for Kosovo." *Croatian Economic Survey* 17 (2): 57–81.
- Gmelch, George. 1980. "Return Migration." *Annual Review of Anthropology* 9: 135–59.
- Hagan, Maria, and Joshua T. Wassink. 2019. "Return Migration and Social Mobility in Mexico." *Current History* 118 (805): 50–55.
- Kadriu, Lumnije. 2024. "Self-Voluntary 'Permanent' Return Migration to Post-War Kosova." In *Return Migration and Its Consequences in Southeast Europe*, edited by Jasna Čapo, Rozita Dimova, and Lumnije Jusufi, 95–117 (47). Berlin: Peter Lang.
- Kadriu, Lumnije. 2018. "The Transnational Family: Between Preserving the Old and Acquiring a New Way of Life." *Ethnologia Balkanica* 21: 173–93.
- Kadriu, Lumnije. 2020. "Paslufta dhe Migrimi i Kthimit në Kosovë." *Albanologji* 10 (2): 43–51.
- King, Russell. 2000. "Generalizations from the History of Return Migration." In *Return Migration: Journey of Hope or Despair?*, 7–55. Geneva: United Nations, IOM.
- King, Russell, and Katie Kuschminder. 2022. "Introduction: Definitions, Typologies, and Theories of Return Migration." In *Handbook of Return Migration*, edited by Russell King and Katie Kuschminder, 1–22. Cheltenham: Elgar Publishing.
- King, Russell. 2022. "Exploring the Return Migration and Development Nexus." In *Handbook of Return Migration*, edited by Russell King and Katie Kuschminder, 314–30. Cheltenham: Elgar Publishing.
- Kotorri, Mrika. 2017. "The Probability of Return Conditional on Migration Duration: Evidence from Kosovo." *South East European Journal of Economics and Business* 12 (2): 35–46.
- Kubiciel-Lodzińska, Sabina, and Jolanta Maj. 2021. "High-Skilled vs. Low-Skilled

- Migrant Women: The Use of Competencies and Knowledge—Theoretical and Political Implications: An Example of the Elderly Care Sector in Poland.” *Journal of International Migration and Integration* 22: 1551–71. <https://doi.org/10.1007/s12134-021-00813-5>.
- Lang, T., B. Glorius, R. Nadler, and Z. Kovács. 2016. “Introduction: Mobility Against the Stream? New Concepts, Methodological Approaches and Regional Perspectives on Return Migration in Europe.” In *Return Migration and Regional Development in Europe*, edited by Z. Kovács, B. Glorius, and T. Lang, 1–22. Basingstoke: Palgrave Macmillan.
- Levitt, Peggy. 2004. “Transnational Migrants: When ‘Home’ Means More Than One Country.” *Migration Policy Institute Online Journal*. Accessed August 22, 2014. <http://www.migrationpolicy.org/article/transnational-migrants-when-home-means-more-one-country>.
- Leutloff-Grandits, Carolin. 2023. *Translocal Care across Kosova’s Borders: Reconfiguring Kinship Along Gender and Generational Lines*. New York: Berghahn.
- Möllers, Judith, Diana Traikova, Thomas Herzfeld, and Egzon Bajrami. 2017. “Study on Rural Migration and Return Migration in Kosova.” *Discussion Paper* no. 166. Leibniz Institute of Agricultural Development in Transition Economies.
- Mustafa et al. 2007. *Diaspora and Migration Policies*. Forum 2015. Prishtina.
- Ni Laoire, Caitriona. 2007. “The ‘Green Green Grass of Home’? Return Migration to Rural Ireland.” *Journal of Rural Studies* 23: 332–44. <https://doi.org/10.1016/j.jrurstud.2007.01.005>.
- Pastore, Gerardo, and Gabriele Tomei. 2018. “High-Skilled Migration and the Knowledge Society: Theories, Processes, Perspectives.” *Arxius de Sociologia* 39: 19–36.
- Population of Kosovo in 2024. Accessed December 2024. <https://datareportal.com/reports/digital-2024-kosovo>.
- Reineck, Janet. 1991. *The Past as Refuge: Gender, Migration, and Ideology Among the Kosova Albanians*. PhD diss., University of California, Berkeley.
- Sorokin, Pitirim. 1959. *Social and Cultural Mobility*. Illinois: The Free Press of Glencoe. [https://ia804704.us.archive.org/13/items/in.ernet.dli.2015.275737/2015.275737\\_Social-And\\_text.pdf](https://ia804704.us.archive.org/13/items/in.ernet.dli.2015.275737/2015.275737_Social-And_text.pdf).
- Vathi, Zana, and Richard Black. 2007. “Migration and Poverty Reduction in Kosovo.” *Development Research Centre on Migration, Globalisation and Poverty*. University of Sussex: Brighton.
- Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, 2024. Agjencia e Statistikës së Kosovës (ASK). Accessed December 2024. <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/8328>.
- Weinar, Agnieszka, and Amanda Klekowski von Koppenfels. 2020. *Highly-Skilled Migration: Between Settlement and Mobility*. IMISCOE Short Reader. Springer.

## Rreth autores

Lumnije Kadriu është bashkëpunëtoe e lartë shkencore në Institutin Albanologjik, Dega e Etnologjisë, në Prishtinë, Kosovë. Ajo është autore e dy monografive: “Glokalizimi: Perceptimet etno-kulturore” dhe “Pushimet, familja dhe vendlindja

në praktikat e diasporës shqiptare të Kosovës”. Ajo është anëtare e bordit redaktues të revistës “Gjurmime Albanologjike: Folklor dhe Etnologji”, botuar nga Instituti Albanologjik në Prishtinë, si dhe e revistës “Antropologji”, botuar nga Instituti i Antropologjisë dhe Studimit të Artit në Tiranë. Gjithashtu është anëtare e SIEF (Shoqata Ndërkombëtare për Etnologji dhe Folklor) dhe InASEA (Shoqata Ndërkombëtare për Antropologjinë e Evropës Juglindore). Interesimet e saj më të fundit kërkimore përqendrohen në globalizimin, transnacionalizmin dhe kthimin e migrantëve.

Përkthimi: Arsim Canolli

Redaktimi i përkthimit: Lumnije Kadriu

Lektura: Adelinë Selmani